



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 443 prot.
128

Tiranë, më 28.12.2022

VENDIM

Nr. 952, Datë 28.12.2022

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ
NDËRMARRJES VODAFONE ALBANIA SHA NË TREGUN E SHËRBIMEVE
CELULARE: TREGU ME SHUMICË I TERMINIMIT TË THIRRJEVE
NDËRKOMBËTARE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i raportit të hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43 pika 5 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Ankesës së ndërmarrjes Neofone SHPK (protokolluar pranë AK me 404 prot., datë 08.09.2021), mbi abuzimin me pozitën dominuese nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare;
- Raportit të hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënia e disa detyrimeve;
- Raportit të hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënia e disa detyrimeve;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e Hetimit të Thelluar;
- Shkresa e ndërmarrjes Neofone SHPK datë 20.12.2022, (protokolluar pranë AK me nr. 443/24 prot., datë 20.12.2022) “Kundërshtime dhe prapësime për “Raport hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare”, nr. 443/17 prot., datë 07.12.2022”;
- Pretendimet/shpjegimet e dhëna nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.12.2022 si dhe të paraqitura me shkrim, në vijim të seancës dëgjimore me nëpërmjet shkresës së datës 27.12.2022 “Kundërshtimi i gjetjeve të hetimit të thelluar”, (protokolluar pranë AK nr. 443/26 prot., datë 27.12.2022.

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja Neofone SHPK, me shkresën protokolluar pranë AK me 404 prot., datë 08.09.2021, ka depozituar ankesën mbi abuzimin me pozitën dominuese nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.
2. Në vijim të ankesës së depozituar, me anë të shkresës nr. 404/1 prot., datë 20.12.2021 “Mbi shqyrtimin e ankesës”, në bazë të nenit 29/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Neofone SHPK në datën 06.01.2022 është ftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës për tu dëgjuar mbi shkeljet e pretenduara, nga ku u konstatua se:
 - Ndërmarrja Neofone SHPK ka lidhur “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike” me ndërmarrjen Vodafone Albania SHA, e cila ka hyrë në fuqi në 1 tetor 2012, me tarifë 6.1 lek/min, e cila ka vijuar deri më 10.04.2015. Sipas ndërmarrjes Neofone, aksesit dhe interkoneksioni në rrjetin e Vodafone Albania u ndërpre, për arsye të prishjes së marrëveshjes, pasi Vodafone për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare të terminuara nga operatori Neofone SHPK e rriti në vlerën nga 6.1 lek/min në 29.8 lek/min, pa dhënë asnjë argument dhe arsyetim.
 - Pas njoftimit nga ana e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA për aplikimin e tarifës së re për shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Vodafone Albania, Neofone SHPK ka kundërshtuar rritjen e tarifës, pasi ishte 5 herë (480%) më e lartë se tarifa e negociuar dhe firmosur në marrëveshjen e tetorit 2012. Sipas Neofone SHPK, Vodafone Albania SHA nuk ka pranuar të ndryshojë dhe as të negociojë tarifën por ka ndërprerë aksesin.
 - Ndërmarrja Neofone SHPK, duke nisur nga data 10.04.2015 dhe në vazhdim, është përballur me kushte të vështira tregtare si pasojë e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA, duke mos pasur mundësi të zhvillojë aktivitetin si tranzitues i trafikut ndërkombëtar për të cilin ishte licensuar që prej datës 13.07.2012 sipas Autorizimit të lëshuar nga AKEP 2012-AP-U60-8-9.
 - Në dhjetor të vitit 2015 ndërmarrja Neofone SHPK i është drejtuar AKEP për të zgjidhur

mosmarrëveshjen midis Neofone dhe Vodafone Albania por AKEP, me shkresë të thjeshtë, e ka njoftuar se ka vendosur mos pranimin e shqyrtimit të ankimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, pasi shërbimi i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare ishte derregulluar nga AKEP, kështu që çdo marrëveshje e mundshme e lidhur ndërmjet palëve është plotësisht e ndërtuar mbi baza komerciale.

- Në vitin 2015, ndërmarrja Neofone SHPK ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë detyrimin e organit administrativ AKEP të shprehet me vendim. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2016 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e palës së paditur që të nxjerrë aktin administrativ në lidhje me ankimin e ndërmarrjes Neofone SHPK. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në vitin 2019 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 - AKEP me vendimin nr. 35, datë 14.10.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit të ndërmarrjes Neofone SHPK për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Neofone SHPK dhe Vodafone Albania SHA, duke argumentuar se, Vodafone Albania, duke mos pasur statusin operator me "Fuqi të Ndjeshme në Treg" (FNT) për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nuk ka asnjë prej detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" për këto thirrje, dhe AKEP nuk mund të detyrojë Vodafone Albania të lidhë marrëveshje aksesit/interkonkesioni me një operator tranzitues për terminimin e këtyre thirrjeve dhe as të rregullojë/përcaktojë tarifën e këtij shërbimi, përfshirë në procedura zgjidhje mos-marrëveshjeje.
 - Ndërmarrja Neofone SHPK në vitin 2020 ka paditur përsëri AKEP pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me ndryshimin e vendimit nr.35/2019 për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Neofone SHPK dhe Vodafone Albania SHA duke përcaktuar tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare që tranzitohen nga Neofone SHPK në rrjetin e Vodafone Albania SHA, të njëjtë me atë kombëtare, në nivelin 1.48 lekë për minute, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Drejtues nr.2542 datë 13.3.2015 të AKEP deri në daljen e analizës së re të tregut. Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.2345 datë 13.10.2020 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim është apeluar nga Neofone SHPK dhe çështja ndodhet pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
3. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 862, datë 31.01.2022, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.
 4. Në zbatim të këtij vendimit, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion me shkresa drejtuar ndërmarrjes Vodafone Albania SHA dhe AKEP.
 5. Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika (1) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", me vendimin nr. 894, datë 24.06.2022, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, për periudhën kohore nga 10 prill 2015 deri në 24 qershor 2022.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

6. Në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
7. Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është një shërbim që kryhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është brenda juridiksionit territorial dhe lëndor si dhe kompetencave të AKEP për të vendosur mënyrën e rregullimit të tij duke garantuar barazi, mosdiskrimin dhe konkurrencë të lirë dhe të ndershme në përputhje me ligjin nr. 9918/2008 dhe legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës.
8. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare është një shërbim me shumicë, i cili përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t’u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti celular.
9. Ofrimi i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare është i pamundur të kryhet nëse nuk ofrohet si input aksesit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, për ti dërguar tek abonenti fundor, nëpërmjet përdorimit të rrjetit publik të operatorëve mobile.
10. Sipas AKEP, asnjë operator celular nuk kërcënohet nga operatorë të tjerë të mundshëm që të hyjnë në tregun individual të secilit prej tyre dhe të ofrojnë shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e një operatori tjetër celular, pasi ky shërbim mund të ofrohet vetëm nga operatori i rrjetit përkatës.
11. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës i produktit është tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin celular Vodafone Albania.
12. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrja Vodafone Albania SHA është e përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëmrisht homogjene.
13. Treg përkatës përkufizohet tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin celular Vodafone Albania, cili përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t’u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti celular në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

II.2 Vlerësimi i pozitës dominuese

14. Përkufizimi i pozitës dominuese është dhënë në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 9121/2003, i cili përcakton se: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”
15. Sipas ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por

zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003.

16. Kriteret kryesore për vlerësimin e pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të Ligjit janë: pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë; barrierat e hyrjes në tregun përkatës; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; fuqia kundërvepruese e blerësve/konsumatorëve; varësia ekonomike e furnizuesve të blerësve; zhvillimi i rrjetit shpërndarës; karakteristika të tjera të tregut përkatës.
17. Tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare dhe fikse kanë qenë nën rregullim nga AKEP në periudhën shtator 2008 - shkurt 2012. Rregullimi i tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në periudhën e cituar është kryer nga AKEP duke i përcaktuar ato të barabarta me Tarifat Celulare të Terminimit (MTR) për thirrjet kombëtare. Arsyeimi i këtij rregullimi është dhënë në dokumentet përkatëse të AKEP (më parë ERT). Në vijim të këtyre vendimeve të AKEP, ofertat referencë të interkoneksionit të tre operatoreve me FNT (AMC, Vodafone dhe Albtelecom fiks), përmbanin në mënyrë eksplicite detyrimin për secilin nga tre operatorët me FNT, që të ofrojnë terminim të thirrjeve ndërkombëtare, operatoreve vendas me tarife të njëjta si edhe terminimi i thirrjeve kombëtare.
18. AKEP me vendimet nr. 1739, 1740 dhe 1741, datë 20.12.2011, vendosi nxjerrjen nga rregullimi i tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom (rrjeti fiks) me efekte nga data 1.02.2012.
19. Në analizën e tregut të vitit 2012, AKEP me Vendimet nr. 2119, 2120, 2121 dhe 2122, datë 4.07.2012 kreu de-rregullimin e plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke e nxjerrë këtë shërbim nga përkufizimi i tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, duke e hequr edhe detyrimet e tjera për FNT si dhënie akses, mos-diskriminim dhe transparencë, me efekt nga data 1.09.2012. Ky qëndrim është mbajtur nga AKEP edhe në analizën e tregut të vitit 2014, si dhe në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik në dhjetor 2016.
20. Bazuar në analizat e tregut deri në vitin 2018, AKEP ka përcaktuar se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare nuk është në të njëjtin treg përkatës si edhe termini i thirrjeve kombëtare për shkak të dimensionit gjeografik por në të dy tregjet secili nga operatorët është me fuqi të ndjeshme në treg (FNT), pasi ka monopolin e terminimit në rrjetin e vet të thirrjeve kombëtare ose ndërkombëtare.¹
21. Ndërmarrja Vodafone Albania sipas përkufizimit nga AKEP zotëron monopolin në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare. Vlera e indeksit HHI (Herfindahl-Hirschman Index) për periudhën nën hetim, bazuar në pjesët e tregut në rastin e një ndërmarrje me pozitë dominuese, është shumë e lartë, në vlerën 10 000. Kjo ndërmarrje në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", ka një pozitë dominuese duke patur 100% të tregut përkatës. Duke u bazuar në ligj dhe në udhëzimin përkatës të pozitës dominuese, por edhe në praktikën më të mirë të Komisionit Europian dhe të OECD, monopoli në këtë rast Vodafone Albania SHA, është një mundësi potenciale që të shkaktojë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.

¹ Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 11, datë 16.06.2020, fq. 54/99.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun përkatës

22. Ndërmarrja Vodafone Albania është një ndërmarrje e autorizuar si ofruese e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe e autorizuar për të tranzituar trafik ndërkombëtar brenda Shqipërisë, sipas parashikimeve të ligjit shqiptar në fuqi.
23. Referuar analizës së fundit të AKEP nëpërmjet vendimit nr. 11, datë 16.06.2020 dhe shkresës së AKEP nr. 104/11 prot., datë 19.05.2022, tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nuk është në rregullim nga AKEP që nga viti 2012, nuk ka të përcaktuar sipërmarrës me FNT, operatorët nuk kanë detyrime specifike për të raportuar të dhënat e gjeneruara, si dhe nuk ka tarifa të përcaktuara.
24. Vodafone Albania SHA për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, për shkak të dërrugullimit të plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nga AKEP, me efekt nga data 1.09.2012, është shprehur se, përgjithësisht, ka vepruar duke vendosur tarifa sipas trendit të tregut shqiptar apo atij rajonal, si dhe e trajton në marrëveshje të veçanta tregtare mes operatorit ofrues të terminimit të thirrjeve dhe atij tranzitues.²
25. Ndërmarrja Vodafone Albania SHA³ për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, për periudhën kohore nga 10 prill 2015 deri në 24 qershor 2022, ka lidhur marrëveshje për shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara, si më poshtë vijon:
- “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike” me ndërmarrjen Abcom SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 1 tetor 2012, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike” me ndërmarrjen Albanian Satellite Communications SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 1 tetor 2012, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike” me ndërmarrjen Nisatel SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 1 tetor 2012, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike” me ndërmarrjen Neofone SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 1 tetor 2012, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike” me ndërmarrjen Info Telecom SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 1 tetor 2012, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike” me ndërmarrjen Abissnet SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 1 dhjetor 2012, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje Interkoneksioni Ndërkombëtar” me ndërmarrjen Unifi Holdings SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 1 korrik 2014, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje Interkoneksioni Ndërkombëtar” me ndërmarrjen VIVO Communications SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 24 prill 2015, me tarifë 6.1 lek/min;
 - “Marrëveshje Interkoneksioni Ndërkombëtar” me ndërmarrjen Selcom SHPK, e cila ka hyrë në fuqi në 9 qershor 2016, me tarifë 25 lek/min;
 - “Marrëveshje Interkoneksioni Ndërkombëtar” me ndërmarrjen FBD SHPK, e cila ka hyrë në

² Shkresat ndërmarrjes Vodafone Albania SHA protokolluar pranë AK me nr. 104 prot., datë 18.03.2022 dhe nr. 443/9 prot., datë 24.10.2022.

³ Shkresa ndërmarrjes Vodafone Albania SHA protokolluar pranë AK me nr. 443/9 prot., datë 24.10.2022.

fuqi në 15 dhjetor 2017, për volumin 0-1,000,000 me tarifë 20 lek/min për periudhën dhjetor 2017 – shtator 2019 dhe, për volumin >1,000,000 me tarifë 41 lek/min për periudhën 1 tetor 2019 e në vijim.

26. Sipas nenit 2 “Kohëzgjatja” të marrëveshjes midis palëve: “Marrëveshja mbetet në fuqi deri sa të përfundohet nga njëra nga Palët duke dhënë një njoftim paraprak me shkrim prej 30 (tridhjetë) ditësh Palës tjetër”.
27. Sipas nenit 4 “Përcaktimi i tarifave” të marrëveshjes midis palëve: “Tarifat mund të ndryshohen në çdo moment nga Pala ofruese e shërbimeve përkatëse duke dhënë një njoftim paraprak prej të paktën 7 (shtatë) ditësh palës tjetër. Në rast të uljes së tarifave ky njoftim do të hyjë në fuqi menjëherë; Pala që merr shërbimin mund të refuzojë ndryshimin e tarifave duke refuzuar përdorimin e shërbimit. Ky refuzim mund të ndikojë kohëzgjatjen e marrëveshjes”.
28. Vodafone Albania SHA sipas informacionit të depozituar⁴ mbi tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara për secilën ndërmarrje që ka lidhur marrëveshje për periudhën kohore nga 10 prill 2015 deri në 24 qershor 2022, është shprehur se kanë vijuar, si më poshtë:
- Tarifat e aplikuar për operatorët deri në 30 qershor 2015 ka qenë 6.1 lek/min;
 - Tarifat e aplikuar për operatorët për periudhën 1 korrik 2015 - 2 maj 2016 ka qenë 13.24 Lek/min.
 - Tarifa e aplikuar për operatorët për periudhën 3 maj 2016 - deri në momentin e një njoftimi të dytë ka qenë 20 lekë për operatorin Unifi dhe 25 lek/min për gjithë operatorët e tjerë.
 - Prej datës 1 nëntor 2019, tarifa e aplikuar ka qenë 21.6 lek/min për FBD dhe 26.5 lek/min për Info-Telecom.
 - Pas njoftimeve individuale të secilit operator, tarifa e aplikuar është unifikuar në 0.305 €/minutë.
 - Për shkak të volumit të konsiderueshëm, si edhe për shkak të terminimit të trafikut ndërkombëtar edhe drejt numrave të bartur në operatorët e tjerë celular, skema e tarifimit të operatorit FBD ndryshon nga ajo e zbatuar për operatorët e tjerë. Për periudhën Dhjetor 2017 - 31 Gusht 2018 volumi 0-1,000,000 me tarifë 20 lek/min dhe volumi >1,000,000 me tarifë 41 lek/min; Për periudhën 1 Shtator 2018 - 30 Shtator 2019 volumi 0-1,000,000 me tarifë 20 lek/min dhe volumi >1,000,000 me tarifë 41 lek/min; Për periudhën nga 1 Tetor 2019 deri në 19 qershor 2022 volumi 0-1,000,000 me tarifë 21.5 lek/min dhe volumi >1,000,000 me tarifë 41 lek/min; Për periudhën nga 20 qershor e në vijim volumi 0-1,000,000 me tarifë 26 lek/min dhe volumi >1,000,000 me tarifë 41 lek/min.
29. Sipas ndërmarrjes Vodafone Albania SHA⁵, tarifat e aplikuar për operatorët për periudhën 30 qershor 2015 ka qenë 6.1 lek/min dhe 1 korrik 2015 - 2 maj 2016 ka qenë 13.24 Lek/min, e argumentuar kjo si rritje graduale e aplikuar edhe për ndërmarrjen Neofone SHPK, e cila ka pasur një Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike me Vodafone Albania SHA deri në 10 prill 2015.

⁴ Shkresa ndërmarrjes Vodafone Albania SHA protokolluar pranë AK me nr. 104/2 prot., datë 18.03.2022.

⁵ Shkresa ndërmarrjes Vodafone Albania SHA protokolluar pranë AK me nr. 104 prot., datë 18.03.2022.

30. Gjithashtu, sipas ndërmarrjes Vodafone Albania SHA,⁶ edhe operatorëve të tjerë që nuk kanë pranuar tarifën e re të njoftuar për rritje, iu është pezulluar shërbimi, si më poshtë vijon:
- Për operatorin Unifi shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 31 dhjetor 2017, pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 20 lek/minutë në 0.305 Euro/minutë.
 - Për operatorin Vivo shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 31 dhjetor 2017, pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 25 lek/minutë në 0.305 Euro/minutë.
 - Për operatorin Nisatel shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 31 mars 2018, pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 25 lek/minutë në 0.305 Euro/minutë.
 - Për operatorin ABcom shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 31 mars 2018, pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 25 lek/minutë në 0.305 Euro/minutë.
 - Për operatorin ASC shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 31 korrik 2019 pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 25 lek/minutë në 0.305 Euro/minutë.
 - Për operatorin Abissnet shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 31 korrik 2019 pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 25 lek/minutë në 0.305 Euro/minutë.
 - Për operatorin Selcom shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 31 tetor 2019 pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 25 lek/minutë në 0.305 Euro/minutë.
 - Për operatorin Info-Telecom shërbimi i terminimit ndërkombëtar është ndërprerë në 30 nëntor 2019 pas njoftimit për rritjen e tarifës nga 26.5 lekë/minutë në 0.305 Euro/minutë.
31. Ndërmarrja Neofone SHPK⁷ nuk ka pranuar tarifën prej 29.8 lek/min e vendosur nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në vitin 2015 për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare ndaj, si rrjedhojë e parashikimit të nenit 4 të Marrëveshjes, kjo marrëdhënie kontraktuale ka përfunduar në mënyrë të njëanshme.
32. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, vihet re se: (i) tarifa e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara ndaj operatorëve të cilët kishin një marrëveshje interkoneksioni me Vodafone ka qenë 6.1 lek/min deri në 30 qershor 2015, tarifë e cila ka vijuar të rritet në mënyrë graduale duke arritur në vlerën 26.5 lek/min në 1 nëntor 2019; (ii) Ndërmarrje të tjera⁸ pas rritjes së tarifës së njoftuar nga Vodafone nuk kanë pranuar dhe nuk kanë ofruar më shërbimin e tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare, por tarifën e rritura të njoftuar nga Vodafone kanë vijuar nga 20 lek/min në vitin 2017 deri në 26.5 lek/min në vitin 2019.
33. Si përfundim, sa më sipër tarifa prej 29.8 lek/min e vendosur ndaj ndërmarrjes Neofone SHPK nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në vitin 2015 për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në kuptim të nenit 9, pika 2, shkronja (c) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përbën abuzim me pozitën dominuese duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.

⁶ Shkresa ndërmarrjes Vodafone Albania SHA protokolluar pranë AK me nr. 104 prot., datë 18.03.2022 dhe nr. 443/9 prot., datë 24.10.2022.

⁷ Shkresa ndërmarrjes Vodafone Albania SHA protokolluar pranë AK me nr. 104 prot., datë 18.03.2022 dhe nr. 443/9 prot., datë 24.10.2022.

⁸ Shiko pikën 30 të këtij vendimi.

IV. Pretendimet dhe kundërshtimet e paraqitura

IV.1 Pretendime të ndërmarrjes Neofone SHPK

34. Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003 ndërmarrjes Neofone SHPK, me shkresën nr. 443/17 prot., datë 07.12.2022 iu dërgua Raporti i hetimit të thelluar si dhe u ftua në seancë dëgjimore për tu dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit të Konkurrencës.
35. Ndërmarrja Neofone SHPK, me shkresën e datës 20.12.2022 (protokolluar pranë AK me nr.443/24 prot., datë 20.12.2022) ka depozituar materialin “Kundërshtime dhe prapësime për “Raport i hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: “Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare”, nr.443/17 prot., 07.12.2022”. Kjo ndërmarrje nuk u paraqit pranë zyrave të AK në ditën e caktuar për tu dëgjuar.
36. Ndërmarrja Neofone SHPK me shkresën e datës 27.12.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 443/25 prot., datë 27.12.2022) “Përgjigje tuajës nr.443/19 prot, datë 07.12.2022 me lëndë “Ftesë për seancë dëgjimore”, kërkon mbajtjen e një seance të re dëgjimore në një datë tjetër, “nëse Komisioni i Konkurrencës e vlerëson të arsyeshme”, pasi shkresa e AK nr. 443/19 prot., datë 7.12.2022 nuk ishte vënë re prej protokollit të Neofone SHPK.
37. Komisioni i Konkurrencës u njoh me pretendimet e ndërmarrjes Neofone SHPK përmes shkrësës së datës 20.12.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 443/24 prot., datë 20.12.2022), ku u depozitua “Kundërshtime dhe prapësime për “Raport i hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: “Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare”, nr. 443/17 prot., 7.12.2022”.
38. Në vlerësimin e Komisionit të Konkurrencës, çdo paqartësi e mundshme u sqarua përmes tërësisë së dokumentacionit sa më sipër, si dhe dokumentacionit të paraqitur prej palës Vodafone Albania. Për këtë arsye, u vlerësua se zhvillimi i një seance dëgjimore tjetër, nuk ishte i nevojshëm. Për më tepër që nga Neofone SHPK nuk u paraqit një arsye serioze për mos paraqitjen në dëgjësë.
39. Ndërmarrja Neofone SHPK në materialin e vet me nr. 443/24 prot., datë 20.12.2022, paraqet disa kërkesa, të cilat Komisioni i Konkurrencës po i liston dhe po iu përgjigjet si më poshtë vijon:
40. *AK të kryejë testin Price Squeeze (Margin Squeeze) për tarifat e ofruara nga ndërmarrja Vodafone Albania për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare.*
41. Në rastin në fjalë, nuk kemi një rrjedhë të poshtme, pasi Neofone SHPK (ndër të tjerë) është perfituesi i shërbimit të terminimit me shumicë të thirrjeve ndërkombëtare ofruar nga Vodafone Albania SHA. Pra produkti i aksesit dhe terminimit të thirrjeve me shumicë shitet nga Vodafone Albania SHA tek Neofone SHPK dhe nuk përdoret nga Neofone SHPK si input për të ofruar shërbime me pakicë për pajtimtarët e tij. Vetë objekti i hetimit dhe i ankesës është terminimi me shumicë i thirrjeve ndërkombëtare, jo i atyre me pakicë. Si rrjedhojë, çdo kërkesë e ankuesit për kryerjen e një “margin squeeze test” del jashtë kontekstit, pasi mungon ofrimi i shërbimeve me pakicë celulare nga ana e Neofone. Krahasoni dhe pika e referencës janë ndërmarrjet si Neofone, në marrëdhënie tregtare me Vodafone Albania për ofrimin e shërbimit të terminimit me shumicë të thirrjeve ndërkombëtare. Për realizimin e një Margin Squeeze Test, duhet të përmbushet

elementi kryesor, i cili është niveli i poshtëm i tregtimit, ku në rastin objekt hetimi, nuk e kemi një të tillë.

42. *Sa është sasia e minutave që ka terminuar vetë Vodafone Albania si ofruese e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe sa është sasia e minutave që ka tranzituar vetë Vodafone Albania si ofruese e shërbimeve publike elektronike, minuta ta cilat i ka marrë po nga Vodafone Albania se ofruese e rrjeteve të komunikimeve elektronike? Pra të llogariten Volumet e Terminuara nga Vodafone Albania dhe të Tranzituara nga Vodafone Albania. Sa % e të trafikut të terminuar në Vodafone Albania është tranzituar nga Vodafone Albania?*
43. Ankuesi e përcakton ndërmarrjen Vodafone Albania SHA si një tranzitues, ndërkohë një subjekt nuk mund të jetë tranzitues në vetë rrjetin e tij, por në kontekstin e ankesës është ofrues i shërbimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare. Për rrjedhojë, mund të themi që Vodafone Albania terminon 100% të trafikut hyrës në rrjetin e tij të drejtuar për pajtimtarët e tij fundorë. Vodafone do të shfaqet si operator tranzitues në rast se do të përcillte trafik të origjinuar nga rrjete të tjera, përmes rrjetit të tij, për tu terminuar në një rrjet tjetër mobil, për shembull One Telecommunications SHA.
44. *Pasi të përcaktohet sasia e minutave, sa është çmimi që Vodafone Albania si ofruese e rrjeteve të komunikimeve elektronike ia ka shitur shërbimin e terminimit në këtë rrjet shoqërisë Vodafone Albania si ofruese e shërbimit publik të komunikimeve elektronike si tranzituese e thirrjeve elektronike? Të përcaktohet sa duhet të ishte tarifa që Vodafone Albania si ofruese e rrjetit duhet ti kishte ofruar sipërmarrësit Neofone, që mos të përbënte shkelje të konkurrencës si konkurrente në ofrimin e shërbimit të tranzitit ndërkombëtar. Të përcaktohet sasia mesatare e minutave që Neofone do të kishte terminuar nëse nuk do të ishte përballur me ndërprerje dhe çmime grabitqare si pasojë e abuzimit me pozitën dominuese dhe shtrembërimit të konkurrencës nga Vodafone Albania? Shkelja e Vodafone Albania është duke vazhduar dhe Neofone kërkon vendosjen e gjohës maksimale për subjektin Vodafone Albania për disa shkelje të rënda të konkurrencës dhe zhdukjen nga tregu të thuajse gjithë konkurrentëve të licensuar nga AKEP.*
45. Vodafone Albania SHA nuk është subjekt i detyrimeve të cilat do të mund të bënin të dallueshme transaksionet midis operacioneve të shumicës dhe pakicës dhe çmimet e shërbimeve reciproke. Për rrjedhojë, mund të themi që Vodafone Albania SHA nuk është e integruar vertikalisht pasi nuk mund t'i shesë vetes së saj.
46. Për arsye se, AKEP në analizën e tregut të vitit 2012, me Vendimet nr. 2119, 2120, 2121 dhe 2122, datë 4.07.2012 kreu de-rregullimin e plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke e nxjerrë këtë shërbim nga përkufizimi i tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare duke e hequr edhe detyrimet e tjera për FNT si dhënie akses, mos-diskriminim dhe transparencë, me efekt nga data 1.09.2012, AK nuk mund të imponojë çmime fikse mbi ndërmarrjet që operojnë në këtë treg. Pavarësisht se tregu është i de-rregulluar, i takon AKEP si rregullator që të ndërhyjë duke marrë vendime rast pas rasti në lidhje me mosmarrëveshjet që ndodhin më këtë treg.
47. Volumet e trafikut janë funksion i shumë parametrave si teknike të lidhura me kapacitetet e lidhjeve midis operatorëve, ashtu edhe me termat ekonomike dhe ato të cilësisë së shërbimit ndaj, sasia mesatare e minutave që Neofone do të kishte terminuar, nuk mund të përcaktohet nga AK. Ligji nr. 9121/2003 nuk e ngarkon AK me detyrimin ta realizojë apo ta përcaktojë këtë.

48. *Të vlerësohet dëmi i shkaktuar nga Vodafone Albania nga momenti i ndërprerjes për shoqërinë Neofone deri në hapjen e aksesit dhe kanaleve për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare.*
49. Nuk është në tagrat e AK të përcaktojë dëmin e shkaktuar. Ligji nr. 9121/2003 nuk e ngarkon AK me detyrimin ta realizojë apo ta përcaktojë këtë.
50. *Të urdhërohet Vodafone Albania të vendosi menjëherë në dispozicion të Neofone rrjetin e vet duke hapur aksesin për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare me tarifë terminimi të orientuar në kosto si ofruese e rrjetit me pretendimin se ndërmarrja Vodafone Albania SHA është duke vazhduar me abuzimin me pozitën dominuese edhe sot.*
51. Ndërmarrja Neofone SHPK ka të drejtë të kërkojë pranë ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në çdo moment ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare si dhe të negociojë për tarifën e saj. AK vlerëson se Vodafone Albania SHA dhe Neofone SHPK aktualisht nuk janë në fazë negociatash për përcaktimin e çmimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918/2008. Në lidhje me “vijueshmërinë e shkejles”, Komisioni i Konkurrencës vlerëson ta trajtojë në mënyrë të specifikë në këtë vendim.

Vodafone Albania SHA si një ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun të thirrjeve ndërkombëtare ka detyrimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, germa “c” të ligjit nr. 9121/2003.

IV.2 Pretendime të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA

52. Në vijim të shkresës nr. 443/20 prot., datë 07.12.2022 dhe nr. 443/22 prot., datë 15.12.2022 “Ftesë për seancë dëgjimore”, në datën 27.12.2022 ndërmarrja Vodafone Albania SHA u paraqit pranë Komisionit të Konkurrencës, për tu dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar.
53. Gjatë kësaj seance (të regjistruar audio), Vodafone Albania parashtroi gojarisht pretendimet e tij, të cilat i paraqiti dhe me shkrim, nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. 443/26 prot., datë 27.12.2022.
54. *Fillimisht, Vodafone Albania SHA paraqet shqetësimin se afati i ankesës dhe marrja në shqyrtim e shkeljes së pretenduar është parashkruar, duke cituar se shkelja e pretenduar ka ndodhur në vitin 2015.*
55. Komisioni i Konkurrencës vlerëson t’i përgjigjet këtij pretendimi në vijim, duke e trajtuar në mënyrë të posaçme.
56. *Vodafone Albania SHA pretendon se në raportin hetimor mungon analiza mbështetëse në lidhje me konkluzionet në fund të tij.*
57. Referuar raportit të hetimit të thelluar, nga faqja 27 deri në faqen 38, është kryer analiza e sjelljes së Vodafone Albania SHA në tregun përkatës në kuptim të nenit 9, pika 2, shkronja (c) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në kuadër të këtij neni, AK në vlerësimin e tij ka ndërmarrë të gjithë hapat dhe proceset e nevojshme për përfundimin e tij në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 si dhe Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

58. *Vodafone Albania SHA pretendon se ka një mungesë provash në hetimin e thelluar, krahasimisht me hetimin paraprak.*
59. Rikujtojmë se gjatë kësaj procedure hetimore, Autoriteti mund të kërkojë informacione dhe dokumente si dhe të urdhërojë inspektive, dëshmi ekspertësh, analiza statistikore dhe ekonomike, apo të konsultohet me ekspertë. Inspektimet e kryera janë pasqyruar në raport, së bashku me procedurat e tjera të ndërmarra prej AK. Vodafone Albania SHA ka ushtruar dhe të drejtën për konsultimin e dosjes në datën 19.12.2022, ku u morën prej tyre një sasi e konsiderueshme dokumentash në formën e njësuar me origjinalen. Këto dokumentacione, dhe të tjera në dosjen hetimore, janë provat e mbledhura prej AK gjatë procesit hetimor. Çdo mungesë dokumentacioni apo faktesh sanksionohet sipas nenit 73 të ligjit nr. 9121/2003. AK ka kërkuar prej palëve gjithë dokumentacionet që ka vlerësuar të jenë të nevojshme për vlerësimin e ankesës së Neofone SHPK, edhe pse pala Vodafone Albania SHA është shprehur se nuk i posedon ato për shkak të kohës së gjatë të kaluar dhe natyrës rutinore të çështjes, siç është shprehur në shkresën 443/14 prot., datë 14.11.2022.
60. *Vodafone Albania SHA është shprehur se AK nuk është e saktë në interpretimin e raporteve të AKEP, ku, bazuar në analizat e tregut deri në vitin 2018, AKEP ka përcaktuar se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare nuk është në të njëjtin treg përkatës si edhe termini i thirrjeve kombëtare për shkak të dimensionit gjeografik por në të dy tregjet secili nga operatorët është me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) pasi ka monopolin e terminimit në rrjetin e vet të thirrjeve kombëtare ose ndërkombëtare.⁹*
61. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator të përcaktuar nga ligji nr. 9918, datë. 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
62. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në zbatim të ligjit nr. 9918/2008, ka si objektiv nxitjen e konkurrencës efikente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera.
63. Analiza e tregut është një proces nëpërmjet të cilit, në baza periodike (jo më pak se një herë në dy vite), AKEP, duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare përcakton tregjet përkatëse, dhe në vijim të kësaj analize përcakton nëse në këto tregje ka konkurrencë efektive. Në rastet kur AKEP evidenton se një apo më shumë sipërmarrës ka Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), atëherë ai vendos masat e nevojshme të njohura si kushtet dhe detyrimet për FNT, me qëllim adresimin e problematikave të tregut. Gjatë këtij procesi, AKEP ushtron të drejtën e tij në rregullimin e këtij sektori specifik si rregullator i vetëm i pavarur në Republikën e Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare. AKEP ushtron funksionet e tij në mbështetje të ligjit nr.9918/2008 dhe akteve të tjera rregullatore, si edhe duke marrë në konsideratë Direktivat dhe Rekomandimet e Komisionit Evropian.
64. AK vlerësimin dhe konstatimin e pozitës dominuese për periudhën hetimore nga 10 prill 2015 deri në 24 qershor 2022 e ka realizuar nga faqja 19 deri në faqen 27 të Raportit të Hetimit të Thelluar, bazuar në nenin 8 të ligjit nr.9121/2003, ku janë vlerësuar elementë si pjesa e tregut,

⁹ Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 11, datë 16.06.2020, faqe 54.

pengesat e hyrjes në treg, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes, fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut.

65. *Vodafone Albania SHA pretendon se AK nuk duhej të kishte marrë në analizën e saj tarifat e aplikuar prej tyre, pasi tregu është i de rregulluar dhe AKEP e ka lënë në tagrin e Vodafone Albania SHA për përcaktimin e tyre.*
66. Neni 673, i Kodit të Procedurës Civile të RSH, parashikon se: “Një ndërmarrje që zë një pozitë dominuese në treg, është e detyruar të kontrakttojë me cilindo që kërkon një detyrim, i cili bën pjesë në objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me ligjet e zakonet e mira tregtare. Përfundimi i një kontrate, nuk mund të refuzohet pa një arsye të ligjshme”. Pra, me të vërtetë Vodafone Albania SHA nuk ka refuzuar në dukje që të kontrakttojë me Neofone, por ka përdorur mekanizmat e përcaktimit të çmimit për të abuzuar me pozitën e saj dominuese, duke aplikuar çmime të ndryshme për shërbime të njëjta. Në të njëjtën kohë, mënyra e vetme në të cilën mund të kryhej hetimi ishte përmes analizës së çmimeve të kontratave të ndryshme midis Vodafone Albania SHA dhe operatorëve të tjerë të cilët kërkonin të ofronin shërbimin e terminimit, pasi vetë ankesa e ndërmarrjes Neofone SHPK në thelb kishte të bënte me çmimin e ofrimit të shërbimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.
67. *Vodafone Albania SHA është shprehur se nga ana e Neofone nuk ka patur një përpjekje konstante për të lidhur një kontratë, madje ka vetëm refuzim nga ana e tyre për negociim të tarifës.*
68. Referuar shkresës së Neofone nr. 404 prot., datë 08.09.2021 “Mbi abuzimin me pozitën dominuese nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, është shprehur se: Pas njoftimit të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA për aplikimin e tarifës së re për shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Vodafone Albania, Neofone SHPK ka kundërshtuar rritjen e tarifës pasi ishte 5 herë më e lartë se tarifa e negociuar dhe firmosur në marrëveshjen e tetor 2012.
69. *Vodafone Albania SHA pretendon se nga aktiviteti i terminimit nuk preket realisht konsumatori fundor.*
70. AK gjatë hetimit të thelluar ka konstatuar se në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, nuk kemi treg pakicë. Neofone (ndër të tjerë) është përfituesi i shërbimit me shumicë të ofruar nga Vodafone. Shërbimi i aksesit dhe terminimit të thirrjeve me shumicë shitet nga Vodafone Albania SHA tek Neofone SHPK, dhe nuk përdoret nga Neofone SHPK si input për të ofruar shërbime me pakicë për pajtimtarët e tij. Zinxhiri i tregtimit në tregun e brendshëm (në RSH) përfundon tek Neofone SHPK. Në këtë rast, në kuptim të ligjit dhe praktikës, me “konsumator” do të kuptohet ndërmarrja Neofone SHPK.
71. *Vodafone Albania SHA ngre pretendimin se nuk është vërtetuar nëse tarifa e përcaktuar është me të vërtetë aq e lartë sa nuk e lejon ndërmarrjen Neofone SHPK të konkurrojë në treg.*
72. Vetë fakti që kjo tarifë është e ndryshme nga tarifa e aplikuar për subjektet e tjera, në një masë shumë herë më të lartë na bën të jemi para konstatimit të abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

73. Në një treg ku, siç është pranuar edhe vetë prej Vodafone Albania SHA që kostot janë minimale dhe thuajse zero, tarifa e shërbimit të terminimit do të ishte pikërisht faktori kryesor që e lejon ose jo një ndërmarrje të jetë konkurruese në treg.

IV.3. Mbi pretendimin e shoqërisë Neofone SHPK për “vijueshmërinë e shkeljes së ligjit” nga ana e Vodafone Albania SHA dhe pretendimin e kësaj të fundit se “afati i ankesës dhe marrja në shqyrtim e shkeljes së pretenduar është parashkruar, duke qenë se shkelja e pretenduar ka ndodhur në vitin 2015”.

74. Autoriteti i Konkurrencës i identifikoi këto dy çështje që në fillim, kur u vu në dijeni përmes ankimit të shoqërisë Neofone SHPK për një shkelje të mundshme të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” nga ana e Vodafone Albania SHA dhe, vlerësoi se, si dy anë të kundërta të së njëjtës medalje, ato ishin në thelb të ndërlidhura dhe mund të merrnin përgjigje vetëm pas një hetimi të plotë të çështjes.

75. Sjellim në vëmendje se, ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nuk e ka rregulluar e, për pasojë, nuk ka identifikuar një numër të caktuar e të mbyllur subjektsh, qofshin këta persona fizikë apo juridikë, privatë apo publikë, të cilët kanë ekskluzivitetin e vënies në lëvizje të Autoritetit të e Konkurrencës. Rrjedhimisht, sikundër është tashmë praktikë e konsoliduar e këtij institucioni, vendosja e tregjeve nën monitorim dhe, kur vërehen problematika, edhe hapja e hetimeve paraprake e të thelluara rast pas rasti, është e drejtë *ex officio, ipso jure*, e Autoritetit të Konkurrencës, pavarësisht se çfarë shërben si nxitje për këtë.

76. Rezulton nga hetimi dhe pranohet nga të dyja palët në këtë çështje se, ndërmarrja Neofone SHPK ka lidhur me ndërmarrjen Vodafone Albania SHA një “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e cila ka hyrë në fuqi në 1 tetor 2012. Kjo marrëveshje ka vijuar deri në 10.04.2015, moment kur, pasi Vodafone Albania SHA për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare të terminuara nga operatori Neofone SHPK e rriti menjëherë dhe në mënyrë të njëanshme vlerën nga 6.1 lek/min në 29.8 lek/min, kjo e fundit refuzoi tarifën e re.

77. Kjo sjellje e Vodafone Albania SHA, siç është argumentuar më lart, përbën abuzim me pozitën dominuese, në kuptim të nenit 9, pika 2, shkronja (c) e ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi Vodafone Albania SHA ka zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.

78. Duke abstraguuar nga thelbi i çështjes, përfaqësuesit e autorizuar të Vodafone Albania SHA, në dëgjuesën e datës 27.12.2022, deklaruan përpara Komisionit të Konkurrencës se, sidoqoftë vlerësimi i Komisionit të Konkurrencës për sjelljen në analizë, ngjarja të cilës ankuesi i referohet si shkelje i takon vitit 2015 dhe, për pasojë, në respekt të legjislacionit shqiptar dhe të BE, është parashkruar.

79. Ndërmarrja Neofone SHPK, në dokumentin e datës 20.12.2022 (i sipërcituar), pretendon se “shkelja e Vodafone Albania është duke vazhduar” (e, për pasojë “subjekti Vodafone Albania duhet të ndëshkohet me gjobë maksimale për disa shkelje të rënda të konkurrencës dhe zhdukjen nga tregu të thuajse gjithë konkurrentëve të licencuar nga AKEP”).

80. Abuzimi me pozitën dominuese në treg parashikohet si shkelje e ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në nenin 9 të tij, sipas të cilit “1) Ndalohet çdo abuzim me pozitën

dominuuese nga një ose më shumë ndërmarrje, që e zotërojnë këtë pozitë në treg. 2) Mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese veçanërisht: [...] c) zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.”

81. Pjesa VI “Kundërvajtjet Administrative dhe Sanksionet” e ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në nenin 74, e identifikon shkeljen e nenit 9 më lart si “shkelje të rëndë”, e cila sanksionohet me vendim të Komisionit të Konkurrencës me “gjobë në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës”.
82. Ligji nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” nuk parashikon afate parashkrimi, përveçse në lidhje me “Sanksionet individuale”, neni 78. Ky nen, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 10 317, datë 16. 09. 2010, rregullon se: “1) Komisioni vendos gjoba në masën deri në 5 milionë lekë mbi individët, që, me dashje ose nga pakujdesia, kryejnë ose bashkëpunojnë në veprimet e sanksionuara në nenet 73 pika 1 dhe 74 pika 1 të këtij ligji. 2) *Vendosja e gjobave, sipas pikës 1 të këtij neni, u nënshtrohet afateve të parashkrimit*¹⁰ prej tre vjetësh, në rastin e përcaktuar në nenin 73 pika 1 të këtij ligji dhe prej 5 vjetësh, në rastin e përcaktuar në nenin 74 pika 1 të këtij ligji.”.
83. Duke vlerësuar me bindje se ndodhemi përpara një rasti tipik të *omisionit legjislativ*, në pamundësi për t’iu referuar *lex specialis*, mbetet t’i referohemi në lidhje me këtë pretendim të Vodafone Albania SHA ligjit (kuadër) nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i cili në nenin 17 “Afatet e shqyrtimit” parashikon “1. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje. 2. Nga rregulli i parashikuar në pikën 1 të këtij neni përjashtohen ato raste, për të cilat: [...] b) ligji i veçantë ka parashikuar afate të ndryshme; c) konstatimi i shkeljeve bëhet nga struktura auditimi apo inspektimi.”
84. Ankesa e ndërmarrjes Neofone SHPK mbi abuzimin me pozitën dominuese nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është depozituar pranë AK më datë 08.09.2021. Në lidhje me këtë fakt nuk ka asnjë pretendim nga palët. Duke iu referuar datës 10.04.2015 kur ka përfunduar marrëveshja mes Neofone SHPK dhe Vodafone Albania SHA, vërehet se kanë kaluar më shumë se 6 vite nga momenti kur ka ndodhur shkelja e ligjit (e argumentuar nga Komisioni i Konkurrencës më lart), deri në momentin kur ndërmarrja Neofone SHPK paraqiti ankimin pranë Autoritetit të Konkurrencës.
85. Periudha prej më shumë se 6 vjetësh, vjen dukshëm në kundërshtim me parashikimin gjeneralist të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.
86. Për një arsyetim të plotë, duke qenë se kjo çështje do të shërbejë si precedent (nuk ka raste të tjera të ngjashme në veprimtarinë e tij), Komisioni i Konkurrencës vlerëson t’i drejtohet edhe *acqui* të Bashkimit Europian, legjislacionit të vendeve të zhvilluara të BE dhe praktikës së Komisionit Europian (KE) dhe Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED), të të dyja dhomave, rast pas rasti.
87. “Marrëveshja e stabilizim asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë”, e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës me ligjin nr. 9590, datë

¹⁰ Theksimi është bërë nga AK, për të sjellë në vëmendje që legjislatori dhe atëherë kur ka vendosur afate parashkrimi e ka bërë këtë vetëm në lidhje me vendosjen e gjobave (shën. i AK).

27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së stabilizim asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, në Titullin VI “Përafrimi i legjislacionit, imponimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës”, nenin 70, pika 1 parashikon se: “Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.”

88. Rregullorja KE 1/2003 “Mbi zbatimin rregullave të konkurrencës të parashikuara nga nenet 81 e 82 të Traktatit për Funksionimin e BE”, në Kreun VII parashikon “Afatet e parashkrimit”. Për specifikën e shkelleve në fushën e konkurrencës, Rregullorja nuk parashikon afate parashkrimi në lidhje me hetimin, por vetëm në lidhje me afatet për vendosjen e gjobave dhe të vjeljes së tyre. Neni 25 i Rregullores, parashikon se: “Kompetencat e dhëna Komisionit¹¹ nga nenet 23¹² dhe 24¹³ do t’i nënshtrohen periudhave të mëposhtme të kufizimit: tre vjet në rast të shkelleve të dispozitave në lidhje me kërkesat për informacion ose kryerjen e inspektimeve; pesë vjet në rastin e të gjitha shkelleve të tjera. Koha fillon të ecë në ditën në të cilën është kryer shkelja. Megjithatë, në rast të shkelleve të vazhdueshme ose të përsëritura, koha fillon të ecë në ditën në të cilën shkelja pushon.”
89. Direktiva e BE-së për Veprimet për Dëmet nga Shkelja e Konkurrencës (“EU Directive on Antitrust Damages Actions”), në nenin 10(2) parashikon se afati i parashkrimit (i cili duhet të jetë së paku pesë vjet) “nuk fillon derisa shkelja të pushojë”.
90. Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në Vendimin C-267/20, “Volvo dhe DAF Trucks” sqaron se “afatet e parashkrimit fillojnë vetëm kur shkelja e ligjit të konkurrencës ka pushuar dhe kur paditësi është në dijeni ose pritët në mënyrë të arsyeshme të jetë në dijeni të (i) ekzistencës së një shkeljeje të rregullave të konkurrencës, (ii) ekzistencës të dëmit, (iii) lidhjen shkakësore midis shkeljes dhe dëmit dhe (iv) identitetin e shkelësit.”
91. Legjislacioni i BE dhe praktika e GjED është adoptuar edhe nga Autoriteti i Konkurrencës përmes aktit-nënligjor Udhëzues nr. 3, datë 26.06.2019 “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Direktiva 2014/104/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 nëntor 2014 “Mbi disa rregulla që rregullojnë veprimet për dëmet e ligjit kombëtar për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian” (OJ L 349, 5.12.2014).
92. Neni 10 i Udhëzimit, me titull “Afati i parashkrimit” udhëzon që: “1. Në çdo rast, mund të përcaktohen rregulla për afatin e parashkrimit lidhur me veprimet që ndërmerren për kompensimin e dëmeve. Këto rregulla përcaktojnë kur fillon afati i parashkrimit, kohëzgjatja dhe rrethanat nën të cilat afati është ndërprerë ose pezulluar. 2. Afati i parashkrimit nuk fillon të llogaritet përpara se shkelja e ligjit të konkurrencës të ketë pushuar dhe paditësi të ishte në dijeni ose prezumohet se mund të ishte në dijeni: a) të sjelljes dhe të faktit se kjo sjellje përbën shkelje

¹¹ Kupto “Komisionit Evropian” (shën. i AK).

¹² Neni 23 i Rregullores titullohet “Gjobat” dhe është transpozuar në legjislacionin tonë përmes neneve 73 e 74 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (shën. i AK).

¹³ Neni 24 i Rregullores titullohet “Pagesat periodike të gjobave” (shën. i AK).

të ligjit të konkurrencës; b) të faktit se shkelja e ligjit të konkurrencës i shkaktoi dëm; dhe c) të identitetit të shkelësit.”

93. Rezulton qartë se ndërmarrja Neofone SHPK ka pasur një interes të vazhdueshëm për të marrë të drejtën e pretenduar ndaj Vodafone Albania SHA; ajo herë pas here i është drejtuar respektivisht rregullatorit sektorial AKEP dhe më pas edhe juridiksionit gjyqësor në lidhje me këtë, por nuk i është drejtuar asnjëherë Autoritetit të Konkurrencës, në respekt të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, deri në vitin 2021. AK është një institucion publik që mbron “konkurrencën e lirë dhe efektive në treg” nga këndvështrimi i të drejtës publike dhe jo i së drejtës private. Edhe penalitetet (gjobat) që parashikon ligji për konkurrencën, pasi kalojnë testin e gjyqësorit, shkojnë në favor të buxhetit të Shtetit e jo të palës së dëmtuar nga marrëveshja e paligjshme (neni 4) apo abuzimi me pozitën dominuese të një a më shumë ndërmarrjeve (neni 9 i ligjit).
94. Rrjedhimisht, ankimet administrative pranë AKEP dhe paditë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk mund të përbëjnë ndërprerje të periudhës së parashkrimit, edhe sikur për këtë t’i referoheshim *acqui* të BE dhe afatit pesë vjeçar.
95. Nga ana tjetër, GjED thekson se “periudha pesëvjeçare e parashkrimit të përcaktuar në Rregulloren nr. 2988/74 mund të ndërpritet nga një kërkesë për informacion sipas nenit 11 të Rregullores 17, me kusht që kjo kërkesë të jetë e nevojshme për hetimin ose procedurat në lidhje me shkeljen” (Vendimi Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, Çështja T-213/00, CMA CGM kundër Komisionit, [2003] E.C.R. II-913).
96. Edhe Ligji gjerman i Konkurrencës (Gesetz gegen Wettbewerbsbeschränkungen – GWB), Seksioni 33h “Afatet e Parashkrimit”, parashikon se “(6) Afatet e parashkrimit për një ankim sipas nenit 33(1) ose nenit 33a(1) do të pezullohen nëse: 3. paditësi ka ngritur padi kundër shkelësit për sigurimin e informacionit ose dorëzimin e provave sipas nenit 33g.”
97. Ndërmarrja Neofone SHPK nuk paraqiti asnjë provë se i është drejtuar në periudhën 2015-2021 ndërmarrjes Vodafone Albania SHA me shkresë apo edhe me postë elektronike për t’i kërkuar informacione apo prova në lidhje me çështjen. Gjatë kësaj periudhe ajo as nuk i është drejtuar ndonjë institucioni publik apo gjyqësor me një kërkesë të ngjashme.
98. Përsa i takon konceptit të “shkeljes së vazhdueshme” apo “vijuese”, ajo në legjislacionin dhe doktrinën europiane identifikohet me togfjalëshin “Shkelje Vijuese e Vetme” (ShVV).
99. Sipas praktikës së Komisionit European (Rasti C-49/92 P “Komisioni v. Anic Participazioni SpA”, paragrafi 8), që një grup marrëveshjesh dhe/ose praktikash të bashkërenduara të konsiderohen si një ShVV, ato duhet të jenë të ndërlidhura nga: 1) një lidhje objektive, pra ekzistenca e një objektivi të përgjithshëm, dhe 2) një lidhje subjektive, pra ndërgjegjësimi për pjesëmarrjen në një marrëdhënie të paligjshme.
100. Për të përcaktuar ekzistencën e një objektivi të përgjithshëm që ndërlidh një sërë praktikash kundër konkurrencës, Komisioni (shiko Çështjet “T-104/95 Cimenteries CBR dhe të tjerët v. Komisionit”, paragrafi 4123 dhe çështjet e bashkuara T-101/05 dhe T-111/05 BASF AG dhe UCB SA v. Komisionit, paragrafët 180-181) duhet vërtetojë se: 1) këto praktika ndajnë tipare të përbashkëta, d.m.th. kanë një lidhje identiteti, dhe 2) kanë natyrë plotësuese, d.m.th. ekziston një lidhje e komplementaritetit. Përveç ekzistencës së një objektivi të përgjithshëm (lidhje objektive),

karakterizimi i ekzistencës së një Shkelje Vijuese të Vetme kërkon një shfaqje të vetëdijes së pjesëmarrësve se ata marrin pjesë në një komplot më të gjerë. Ky kriter mbulon dy aspekte: 1) nëse ndërmarrja synon të kontribuojë me sjelljen e saj në objektivin e përgjithshëm të ndjekur nga pjesëmarrësit në shkeljen e ligjit, dhe 2) nëse ndërmarrja ka dijeni për veprimet e paligjshme të pjesëmarrësve të tjerë në funksion të të njëjtit objektivi, ose ka mundur të parashikojë në mënyrë të arsyeshme se veprimet e tilla të paligjshme do të kishin ndodhur.

101. Sipas Gjykatës së Përgjithshme, “secila nga format e sjelljes që përfshin shkeljen e vetme dhe të vazhdueshme të ligjit duhet domosdoshmërisht të karakterizohet si një shkelje e veçantë” (Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë në çështjen C-697/19 P, Sony Corporation dhe Sony Electronics v. Komisioni, C-698/19 P).
102. AK sjell në vëmendje se, mbi pretendimin se abuzimi me pozitën dominuese nga Vodafone Albania SHA ka qenë vijues, sipas legjislacionit shqiptar dhe jurisprudencës së GjED “barra e të provuarit të shkeljes i takon palës që pretendon shkeljen” (Vendimi i Gjykatës së Përgjithshme i 26 janarit 2022, çështja Intel Corporation Inc v. Komisionit Evropian).
103. Nga analiza e provave të siguruara prej hetimit të thelluar dhe, në dritën e praktikës së Komisionit Evropian e të GjED, Komisioni i Konkurrencës nuk krijon bindjen e plotë se abuzimi me pozitën dominuese nga ana e Vodafone Albania SHA ka vijuar edhe përtej vitit 2015. Duke pasur parasysh edhe se, masa e sanksionit administrativ që parashikon ligji nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas jurisprudencës së GjEDNj krahasohet me sanksionet në çështjet penale, atëherë edhe në këtë vendimarrje të Komisionit të Konkurrencës gjen vend zbatimi i parimit “*in dubio, pro reo*” (GjED, Vendimi i C-625/13 P.Villeroy & Boch AG v. Komisionit).
104. Në kuptim të sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, megjithëse konstaton se sjellja e Vodafone Albania SHA, përbën abuzim me pozitën dominuese, në kuptim të nenit 9, pika 2, shkronja (c) e ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjendet në pamundësi ligjore për ta sanksionuar këtë shkelje të ligjit me gjobë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA të mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht:
- a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;

- b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
- c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

III. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.


IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Leida MATJA
()
Zv/Kryetar

Rezana KONOMI
()
Anëtar

Adriana BERBERI
()
Anëtar

Durim KRAJA
()
Anëtar

